



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



Nr 02-170106-56113 dt. 27/10/2022

Bazuar në nenin 11,12, dhe 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 34.pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, bazuar në nenin 3, pika 3.5, të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë, **27.10.2022**, miratoi këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e Prof.Dr. Rexhep Meidani "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit

Neni 1

Më këtë Vendim të Kuvendit të Komunës miratohet shpallja e Prof. Dr. Rexhep Meidani "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli "Qytetar Nderi" Prof. Dr. Rexhep Meidani i jepet për kontributin e tij për çështjen e Kosovës, në të gjitha nivelet, ato shkencore, politike dhe shoqërore, përgjatë dekadave.

Neni 3

Titulli Qytetar Nderi sipas këtij Vendimi do të ndahet nga kryetari i Komunës, i cili autorizohet të përcaktoj formën e dekoratës, mënyrën e dhënies si dhe çështjet tjera sa i përket organizimit të ndarjes së titullit.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatesë;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit;
Palës;



ARSYETIM

Prof. Dr. Rexhep Meidani lindi më 17 gusht 1944 në Tiranë. U diplomua në Universitetin e Tiranës në vitin 1966, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), dega Fizikë, si dhe përfundoi me sukses studimet pasuniversitare në Universitetin e Kanës, në Francë, në vitin 1974.

Në fushën profesionale zoti Meidani punoi fillimisht si pedagog, si shef katedre dhe më pas si dekan i FSHN-së në vitet 1966- 1996. Gjatë kësaj periudhe zoti Meidani botoi një numër të madh studimesh, librash dhe artikujsh brenda e jashtë vendit. Zoti Meidani mban titullin shkencor “Profesor, Doktor”.

Karriera politike e zotit Meidani nisi pas viteve '90. Ai ishte Kryetar i KQZ-së në zgjedhjet e para shumëpartiake më 1991 dhe anëtar i Këshillit Presidential në vitin 1991. Gjatë viteve 1992-'96 u angazhua në shoqërinë civile duke qenë edhe kryetar i bordit të Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut (1994-96). Më 1996 aderoi në Partinë Socialiste duke u zgjedhur Sekretar i Përgjithshëm i saj (1996-1997).

Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të qershorit 1997 zoti Meidani u zgjodh deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Pas zgjedhjeve, të cilat u fituan nga koalicioni i majtë i drejtuar nga Partia Socialiste, më 24 korrik 1997 me propozim të PS-së, Kuvendi i Shqipërisë e zgjodhi Prof. Dr. Rexhep Meidanin President të Republikës.

Prof. Dr. Rexhep Meidani ka dhënë kontributin e jashtëzakonshëm në arsimimin e gjeneratave të reja, promovimin e vlerave kombëtare dhe interesit nacional.

Rroli i ish presidentit Meidani, gjatë luftës tonë çlirimtare, ishte i madh, duke qenë thellësisht i lidhur me vuajtjet e popullit shqiptar jashtë kufijve administrativ të Republikës së Shqipërisë.

Angazhimi i ish presidentit Meidani për çështjen e Kosovës, në të gjitha nivelet, ato shkencore, politike dhe shoqërore, përgjatë dekadave, është për t'u vlerësuar me titullin “Qytetar nderi” i komunës së Drenasit.